



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-189 559/23 më 12. 09. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me gjendjen civile.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Skender Tora, kryesues, Sektori i Gjendjes Civile;
 2. Faton Dragusha, anëtar, Sektori i Gjendjes Civile ;
 3. Valdet Vrapça, anëtar, Sektori i Gjendjes Civile.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me gjendjen civile.
- IV. Për kryerjen e detyrës si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen, Vendimi Nr. 14-020/04-36174/22 dt. 18.02.2022 dhe Vendimi Nr. 14-020/05-99715/22 dt.06.05.2022.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

